



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Podujevës**  
Opština Podujevo –Municipality of Podujeva



<b>Data/Date:</b>	13.04.2022
<b>Nga/Od/From</b>	Avni Fetahu, drejtor i DKA-së
<b>Për/Za/To:</b>	Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Podujevës, Ilmi Hoxha
<b>CC</b>	
<b>Tema/Subjekat/Subject</b>	Raporti për ecurinë e hartimit të Rregullores për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Ligjin për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Udhëzimin Administrativ (MAPL) për Transparencë në Komuna, Udhëzimin Administrativ (MAPL) nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, rregulloren (MAPL) nr. 02/2021 për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës, Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18 në zbatim të Planit të Veprimit për Transparencë për periudhën 2018-2023.

Pas hartimit të draft rregullores për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës nga Drejtoria Komunale e Arsimit janë bërë hapat si vijon:

Më datë 15 shkurt 2022, Drejtoria e Arsimit i propozon Kuvendit të Komunës së Podujevës Draft rregulloren për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës me nr. 05/615/03-0011064/22.

Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më: 28 shkurt 2022 miraton: Vendimin për vënien në diskutim publik me nr. 01-070/05-0014622/22, të Propozim Rregullores për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës.

Sipas këtij vendimi, diskutimi publik ka zgjatur 30 ditë përkatësisht prej 04 mars deri më 04 prill 2022, brenda të ciles Drejtoria e Arsimit ka organizuar debat publik me qytetarë, debat ky që është mbajtur më 15 mars 2022.

Ndërsa, propozimet, sygjerimet, apo vërejtjet eventuale janë marrë direkt gjatë diskutimit publik po ashtu edhe në formë elektronike në adresen: selmangashi@rks-gov.net.

## **Publikimi dhe njoftimi i publikut me Draft rregulloren për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës**

-Me 03 mars 2022, është publikuar Drafti i rregullores dhe vendimi me datat përkatëse në uebfaqen zyrtare të komunës po ashtu edhe në faqen e Facebookut të Komunës është publikuar si rikujtim më datë 11 mars 2022., janë njoftuar përmes emailit drejtorët e shkollave të cilët e kanë shërndarë njoftimin/vendimin dhe draftin tek punëtorët e shkollave të tyre.

-Publikimi në uebfaqe: <https://kk.rks-gov.net/podujeve/wp-content/uploads/sites/25/2022/03/7.Vendim-per-venie-ne-diskutim-publik-Draft-Rreg.per-institucionet-arsimore.pdf?fbclid=IwAR3tRsud59inPbWO8abvtUyl6w7xdoaKIMwyBioUIBoCghruzQGaH6C0AZ0>

-Publikimi facebook: <https://www.facebook.com/KomunaEPodujeves/posts/273237621658180>

**Më datë 15 mars 2022** është mbajtur konsultimi publik me qytetarë, në këtë konsultim të pranishëm kanë qenë rreth **45**, qytetarë po ashtu edhe gjatë kohës së paraparë për të dërguar komentet, sygjerimet, plotesimet në e-mail janë dhënë këto komente disa nga të cilat më pas janë inkorporuar në rregullore para se të miratohet.

### **Komentet:**

#### **➤ Liridon Mulliqi, drejtor në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani”-Podujevë:**

- Tek Neni 14; të largohet pika 1.15, sepse UA nr. 18/2009 është shfuqizuar nga UA nr. 31/2014
- Neni 24, Të shtohet: Këshilli i mësimdhënësve miraton suksesin në fund të secilës periudhë dhe në fund të vitit shkollor pas realizimit të afateve të riprovimeve.

Këshilli i mësimdhënësve takohet në fund të çdo periudhe mësimore, por mund të thirren takime me urgjencë varësisht prej rasteve që kërkohet.

#### **• Neni 25; pika 2 të shtohen këto detyra:**

- Aktivet profesionale hartojnë planin vjetor të punës së aktivitetit.
- Kontribuojnë në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës (PZhSh) dhe Planit Vjetor të Shkollës.
- Aktivitet Profesional (AP) zhvillojnë programet mësimore, planet vjetore, dymujore, javore dhe ditore në kuadër të aktivitetit dhe në bashkëpunim me fushat tjera.
- Hartojnë planin vjetor të vlerësimit të nxënësve dhe instrumentet që do të përdoren për vlerësim.
- Harton planin vjetor për zhvillim profesional të mësimdhënësve anëtarë të aktivitetit duke përfshirë vëzhgimet dhe mentorimet ndërkolegiale.
- Harton planin e aktiviteteve jashtëkurrikulare si garat e nxënësve, vizitat me karakter edukativo-arsimor, si dhe aktivitete tjera që kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave.

-Neni 28; pika 6: Në fund të kësaj fjalie të shtohet:

Secili plan duhet të dorëzohet sipas afatit të planifikuar, plani vjetor deri me 25 gusht dhe planet mujore deri me datën 28 të muajit paraprak.

-Neni 28; pika 11: Ti shtohet fjalisë : ... atëherë ai adresohet te kujdestari I klasës, i cili duhet ta njoftoj drejtorin (zv.drejtorin) e shkollës dhe prindin.

-Neni 28 të shtohen: - Mësimdhënësi obligohet të paraqitet në punë 15 minuta para fillimit të procesit mësimor.

- Të shenoj me kohë orën mësimore në ditar, t'i evidentojë të gjithë nxënësit që mungojnë dhe të mos i shenoj orët e pa mbajtura.

- Në asnjë rast, mësimdhënësi nuk ka të drejtë të ofendojë, ngacmojë ose ndëshkojë fizikisht nxënësin. Në rast të nxitjes së situatave të paddshirueshme te përgjithshme nga jokorrektësia në sjellje të nxënësit, duhet të njoftohet drejtori dhe të largohet , nxënësi përkohësisht nga shkolla, derisa të zhvillohen procedurat disiplinore në përputhje me ligjin. Masat e tilla shqiptohen nga drejtori i shkollës, në konsultim me kujdestarin e klasës dhe profesorin e lëndës.

- Në të gjitha rastet e ndëshkimit të nxënësit ose largimit nga ora, duhet të njoftohet prindi. Në asnjë rast sjellja e nxënësit nuk duhet të reflektojë ndëshkim në notim. Nota përcakton nivelin e arritjes së dijes në lëndën e caktuar dhe nuk vlerëson sjelljen e nxënësit.

- Mësimdhënësit i ndalohet të përdor telefonin gjatë procesit mësimor.

-Mësimdhënësit i ndalohet të vendos notë mbi notën e përparme, apo të fshihet nota e të vendoset tjetra,sepse nota e tillë konsiderohet e falsifikuar. Në rast të gabimeve përmirësimi duhet të bëhet pas njoftimit të drejtorit/zv.drejtorit dhe të nënshkruhet dhe vuloset.

- Mësimdhënësit përmes planit të vlerësimit janë të obliguar të zbatojnë parimin e transparences, duke i njoftuar nxënësit se si do të vlerësohen dhe çfarë pritjet të dijnë ata në lëndët përkatëse.

- Mësimdhënësit duhet të respektojnë planin (afatet) e vlerësimit sipas planifikimit të shkollës dhe vlerësimi të bëhet gjatë orëve të rregullta. Në rastet tjera duhet të njoftohet drejtori i shkollës.

- Mësimdhënësi obligohet që notimin ta bëj në prani të nxënësit dhe vetëm me laps kimik me ngjyrë të kaltër.

- Mësimdhënësit në rastet e mungesave nga puna duhet të gjej zëvendësim nga kolegët e lëndës së njëjtë apo koleg të së njëjtës klasë, me qëllim të kompensimit të mëvonshëm të ores së humbur. Rastet e arsyeshmërisë së mungesave janë të parapara me kontratën e punës.

➤ Neni 55; pika L: T'i shtohet fjalisë kjo pjesë ... dhe mbledhjet tjera në kuadër të aktiveve profesionale.

**Shënim: Të gjitha pikat e cekura më lartë vlerësohen si të bazuara ndaj do të inkorporohen në rregullore.**

➤ **Jakup Berisha, mësimdhënës në SHFMU “Luigj Gurakuqi”-Batllavë**

-Neni 14; pika 1.7 : Pjesa e parë e fjalisë nuk është e konkretizuar në masën e nevojshme, sepse lë hapësirë për keqkuptime dhe duhet të jetë „Drejtori i shkollës do të” - Përcjellë MBARËVAJTJEN e tërë procesit mësimor të të gjithë pjesëmarrësve në proces duke vërtetuar përputhshmërinë e kryerjes së obligimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Neni 14; pika 1.16 : duhet të modifikohet si vijon: Menaxhimi i buxhetit të shkollës do të bëhet në koordinim të plotë me Këshillin Drejtues të Shkollës duke i'u dhënë prioritet të veçantë plotësimit të kërkesave higjieno-klimatike, urbanistike dhe demografike të institucionit – shkollës.

- Neni 16; pika 1.18: duhet të modifikohet si vijon: Thirrjen dhe hapjen e mbledhjeve të Këshillave të mësimdhënësve e bënë drejtori ndërsa udhëheqjen e mbledhjes e bëjnë kryetarët e këshillave të mësimdhënësve

- Neni 28; pika 6 : duhet të modifikohet/shtohet si vijon: Mësimdhënësi përgatit të gjitha planet dhe programet arsimore mbështetur në strategjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënies bashkëkohore. Planet dhe programet duhet të jenë të mbështetura në kornizën kurrikulare dhe t'i përgjigjen novacioneve të reja mësimore.

**Shënim: Të gjitha pikat e cekura më lartë vlerësohen si të bazuara ndaj do të inkorporohen në rregullore.**

➤ **Besnik Uka, drejtor në SHFMU “Naim Frashëri Podujevë:** Tek neni 8 struktura organizative e institucioneve edukative-arsimore të evidentohet edhe koordinatori i cilësisë, po ashtu me nen të veçantë të evindtohen detyrat dhe përgjegjësitë e tij të cilat janë të rregulluara edhe me Udhëzimin Administrativ nr. 24/2016.

**Shënim: Pikat e cekura më lartë vlerësohen si të bazuara ndaj do të inkorporohen në rregullore.**

**Fadil Halimi, Kryetar i SBASHK-ut në Podujevë:** Në emër të sindikatës së arsimit konstatojmë se Neni 29 është i pajustificueshëm, vëllimi i punëve të kujdestarit të një paraleleje, i cili ka shumë përgjegjësi si me ditare të nxënësve, mbledhje me prindër e shumë punë tjera administrative. I njëjti mësimdhënësi duhet të përgatitet edhe për 40 orët mësimore dhe me plan konspekte ditore, plane mujore e vjetore.

Ndaj, për gjithë këtë vëllim të punëve të mësimdhënësit kujdestar të një paraleleje, në emër të Sindikatës së Arsimit kërkoj që atij t'i paguhet së paku dy orë shtesë, pasi që edhe bën punë shtesë. **(Ky koment nuk do të përfshihet në rregullore për shkak se e njëjta çështje do të rregullohet me UA nga MASHI duke filluar nga viti 2023).**

-Po ashtu me draft rregullore puna e edukatoreve parafillore është e ngarkuar, pasi që punojnë me dy grupe brenda një institucioni që ka mbi 20 fëmijë, në të kundërtën nëse nuk i ka duhet të mbaj mësim në shkollë tjetër. **(Ky koment nuk do të përfshihet në rregullore për shkak se e njëjta çështje është e rregulluar me UA. 19/2016 në nenin 5 pika 14).**

➤ **Musli Muçiqi, drejtor në SHFMU "Naum Veçilharxhi"-Llapashticë e Epërme:** Propozon që Neni 31 pika 3 : Edukatori/ja të punoj me dy grupet të fëmijëve brenda institucionit nëse ka mbi 20 fëmijë në të kundërtën është i obliguar që me grupin tjetër të mbaj mësim në një institucion/shkollë tjetër. Në të kundërtë nëse punon vetëm me një grup të fëmijëve atëherë paguhet me gjysmë norme; **(proponohet që edukatori të punojë vetëm brenda një institucioni dhe numri i fëmijëve në një grup të jetë deri në 15 fëmijë mbi këtë numër të formohet grupi i dytë).**

**(Ky koment nuk do të përfshihet në rregullore për shkak se e njëjta çështje është e rregulluar me UA. 19/2016 në nenin 5 pika 14).**


**Bashkangjitur në këtë raport janë edhe këto dokumente:**

1. Vendimi /Njoftimin për mbajtjen e konsultimit publik
2. Lista e nënshkrimeve të qytetarëve dhe zyrtarëve pjesëmarrës në konsultimin publik
3. Fotografitë nga mbajtja e diskutimit publik

13.04.2022

Avni Fetahu

Drejtor i DKA-së
















## DREJTORIA E ARSIMIT

### PROCESVERBAL

#### NGA TAKIMI PUBLIK ME QYTETARË DHE PUNËTOR ARSIMOR, I MBAJTUR MË 15 MARS 2022

Takimi filloi në orën 11:00

Takimin e hapi dhe e kryesoi **z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit- Podujevë**. Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (rreth 45 - bashkëngjitur lista e pjesëmarrësve), Drejtorët e shkollave të Komunës së Podujevës, mësimdhënës, përfaqësuesi i SBASHK.

**z. Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit**, e hapi takimin duke përshëndetur të pranishmit dhe duke ju dëshiruar mirëseardhje, ndër të tjera theksoi, në bazë të dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale dhe të Statutit të Komunës kam ftuar këtë takim me ju qytetarë të nderuar.

Ashtu siç edhe jeni të informuar, në këtë takim si temë është paraparë për diskutim është:

#### ➤ **PROPOZIM RREGULLORJA PËR FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONEVE EDUKATIVE-ARSIMORE TË KOMUNËS SË PODUJEVËS**

Të nderuar të pranishëm propozim Rregullorja për funksionimin e institucioneve edukative-arsimore të Komunës së Podujevës është dokument që ka qenë i kërkuar dhe i nevojshëm për vite me radhë, duke ditur rëndësinë dhe nevojën për të si DKA kemi hartuar këtë propozim rregullore me të cilën do të jetë më i lehtë funksionimi i institucioneve edukative-arsimore në komunën tonë.

Ky diskutim publik dhe ky takim me ju është mëse i nevojshëm, andaj do të marrim me seriozitet vërejtjet, propozimet, sugjerimet dhe rekomandimet tuaja në mënyrë që ta plotësojmë dhe ta pasurojmë këtë propozim rregullore.

Drejtori i DKA-së pas fjalës së tij ia dha fjalën zyrtarit të pranishëm në takim **z. Selman Gashi** i cili po shtu theksoi se: Kjo rregullore është e një rëndësie të madhe për arsye se në të janë të përfshira/grumbulluara rregulla dhe detaje që do të lehtësojnë funksionimin e shkollave të komunës sonë, po ashtu ai tha se të gjitha propozimet, sygjerimet dhe rekomandimet e juaja mund t'i dërgoni me shkrim në email adresën time zyrtare [selman.gashi@rks-gov.net](mailto:selman.gashi@rks-gov.net) të cilat çështje gjithashtu do t'i trajtojmë edhe këtu bashkarisht.

Gjatë dëgjimit publik, punëtorët arsimorë dhe qytetarët dhanë propozimet dhe vërejtjet e tyre për funksionalizimin e institucioneve edukative-arsimore, e ku morën sqarime nga drejtori i drejtorisë përkatëse duke i siguruar që propozimet dhe sygjerimet e tyre do të shqyrtohen dhe nëse janë të nevojshme dhe të mundshme të përfshihen në rregullore.

#### **Komentet:**

➤ **Liridon Mulliqi, drejtor në Gjimnazin “Aleksandër Xhuvani”-Podujevë:**  
Mori fjalën dhe tha që komentet lidhur me draft rregulloren do t’i dërgoj në emailin e paraqitur në vendimin e DKA-së të miratuar në Kuvend Komunal.

➤ **Besnik Uka, drejtor në SHFMU “Naim Frashëri Podujevë:** Tek neni 8 struktura organizative e institucioneve edukative-arsimore të evidentohet edhe koordinatori i cilësisë, po ashtu me Nen të veçantë të evindtohen detyrat dhe përgjegjësitë e tij të cilat janë të rregulluara edhe me Udhëzimin Administrativ nr. 24/2016.

➤ **Fadil Halimi, Kryetar i SBASHK-ut në Podujevë:** Në emër të sindikatës së arsimit kërkoj që të inkorporohet pjesa ku kujdestaria duhet të paguhet pasi që numrohet si punë shtesë.

Po ashtu me draft rregullore puna e edukatoreve parafillore është e ngarkuar, pasi që punojnë me dy grupe brenda një institucioni që ka mbi 20 fëmijë, në të kundërtën nese nuk i ka duhet të mbaj mësim në shkollë tjetër. (dhe deklaroi që më gjerësisht do t’i dërgoj komentet në e-mail).

➤ **Musli Muçiqi, drejtor në SHFMU “Naum Veçilharxhi”-Llapashticë e Epërme:**  
Propozon që Neni 31 pika 3 : Edukatori/ja të punoj me dy grupet të fëmijëve brenda institucionit nëse ka mbi 20 fëmijë në të kundërtën është i obliguar që me grupin tjetër të mbaj mësim në një institucion/shkollë tjetër. Në të kundërt nëse punon vetëm me një grup të fëmijëve atëherë paguhet me gjysmë norme; (**propozohet që edukatori të punojë vetëm brenda një institucioni dhe numri i fëmijëve në një grup të jetë deri në 15 fëmijë mbi këtë numër të formohet grupi i dytë**).

Për fund drejtori i DKA-së Avni Fetahu konstaton që meqë nuk ka të pranishëm tjerë që kanë kërkuar fjalën, falënderoi të gjithë për pjesëmarrje dhe për kontributin e dhënë në këtë takim.

**Takimi përfundoi në ora 12:05**

**Procesverbalin e mbajti,  
Selman Gashi, zyrtar në DKA**

**Nr. 05-060/04-0026960  
Podujevë,  
15 mars 2022**

**Drejtori i DKA-së  
Avni Fetahu**  
  
Page 2 of 2

